



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: Primitjeno: 22.01.2025		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtet, Data
01-052/01	3957	



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

## ZYRA E KRYETARIT

### Raport nga mbledhja e dytë publike e thirrur nga kryetari i komunës në dhjetor të vitit 2024

#### Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-016/0163314, e datës 26.12.2024 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në komunë, Komuna e Lipjanit harton procesverbal nga mbledhja e dytë publike e thirrur nga kryetari i komunës për periudhën janar-dhjetor 2024 i cili është mbajtur me datën 27.12.2024, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 10:00. Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Komuna është e obliguar të mbaj dy tubime me publikun, njërin në gjashtëmujorit e parë të vitit fiskal dhe tjetrin në fundvit.

#### Ecuria e Procesit

Zyrtari përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e konsultimit publik në Komunën e Lipjanit ka bërë me kohë lajmërimin dhe ka publikuar njoftimin në ueb faqe të Komunës, në dy gjuhët zyrtare, dy javë para mbajtjes, sipas ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe dispoziata e Udhëzimit administrativ (MAPL) për Administratë të Hapur në komuna.

Po ashtu njoftimi është vendosur edhe në hyrje të objektit të komunës si dhe në vendet e tjera më të frekuentuara nga ana e qytetarëve.

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2024/06/27764.pdf>

Pas hartimit të këtij raporti dhe dhënies së protokollit të brendshëm, i njëjti do t'i dërgohet të gjitha drejtorive dhe njësive komunale.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/kontribuesve
1. Publikimi në ueb faqe	14 ditë pune	69
2. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	14 ditë pune	69

Në këtë tubim publik kanë marrë pjesë **69** pjesëmarrës, prej tyre **22** femra dhe **47** meshkuj.

Takimi i cili është mbajtur **27.12.2024** duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit Komunal ku kishte karakterin informues për të gjithë pjesëmarrësit. Përfaqësuesit e komunës kanë njoftuar për aktivitetet komunale, të arriturat dhe vështirësitë, për synimet dhe investimet kapitale gjatë periudhes për të cilën është thirrur takimi, ndërsa të pranishmit paten rastin të bëjnë pyetje dhe të japin propozime lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara si dhe për çështje të tjera që janë në interes të tyre dhe gjithë qytetarëve të tjerë.

Për të folur rreth aktiviteteteve të Komunës, për planet dhe sfidat, fjala kryesore i takoi kryetarit të komunës, Imri Ahmeti.

Në prani të drejtorëve të Drejtorateve komunale, përfaqësuesve të Këshillave Lokal përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe shumë qytetarëve tjerë, mbledhjen e hapi kryetari i Komunës, Imri Ahmeti ku takimin e filloi duke i njoftuar të pranishmit punën gjatë periudhes janar-dhjetor 2024 të qeverisjes lokale ku bashkarisht kanë diskutuar për të gjitha projektet, të arriturat dhe sfidat gjatë kësaj periudhe.







Kryetari Ahmeti shprehu kënaqësinë për investimet e realizuara gjatë vitit, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Komunës së Lipjanit. Ai cilësoi vitin 2024 si një vit shumë të suksesshëm, duke ia atribuar këtë sukses qytetarëve të Lipjanit.

Në këtë takim, Kryetari Ahmeti veçoi disa nga projektet kryesore, duke përmendur ndërtimin e nënkalimit dhe parkingut nëntokësor, asfaltimin e mbi 62 kilometra rrugë, ndërtimin e 9 kilometra trotuare, shenjzimin dhe ndriçimin publik. Në sektorin e shëndetësisë, po ndërtohet qendra urgjente në qytetin e Lipjanit dhe Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF). Në arsim, janë realizuar renovime efikase të shkollave në disa vendbanime, ndërsa mbi 800 fermerë kanë përfituar mbështetje. Në fushën e sportit dhe kulturës, janë alokuar mbi 205 mijë euro.

Kryetari Ahmeti u shpreh i bindur se në vitin e ardhshëm do të realizohen edhe më shumë projekte, ndonëse përmendi edhe sfidat që kanë shoqëruar punën e deritanishme. Ndër sfidat kryesore, ai theksoi mungesën e mbështetjes nga niveli qendror dhe çështjet e lidhura me kontratat kolektive.

Kryetari Imri Ahmeti para të pranishmëve ka thksuar edhe Sfidat të cilat nuk kanë qenë të lehta dhe kanë përfshirë kryesisht mungesën e mbështetjes financiare për përpjekjet tona, si dhe pengesat në Organin e Shqyrtimit të Prokurimit (OSHP), ku kemi disa lëndë. Një nga këto është Shtëpia e Kulturës, një projekt që presim të fillojë, por që ende po zhagitet në shkallën e dytë të OSHP-së. Po ashtu, është çështja e urës së shtratit të Lumit Sitnica dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik, e cila, me apo pa qëllim, po na dëmton. Janë gjithashtu disa lagje që kanë nevojë për ndriçim public.

Kryetari Ahmeti, theksoi se komunat nuk janë nënshkruese të kontratave kolektive, por pasojat e tyre po i bartin vetë ato.

Një ndër problemet më të mëdha që kemi hasur gjatë këtij viti dhe që mendoj se do të vazhdojë edhe vitin e ardhshëm është përmbarimi gjyqësor për kontratat kolektive të punëtorëve të arsimit. Ekzekutimi përmes përmbaruesve privatë prek buxhetin e komunave, përfshirë buxhetin e komunës sonë. Kjo ka penguar realizimin e projekteve shtesë, sepse komunat, ndonëse nuk janë nënshkruese të këtyre kontratave, bartin pasojat e tyre

Kryetari Imri Ahmeti po ashtu ka folur edhe për realizimin e buxhetit të komunës për vitin 2024 i cili ka qenë i suksesshëm, me rreth 97.62% të buxhetit total të realizuar, ndërsa investimet kapitale kanë tejkaluar pritshmëritë, duke arritur në 95.60%.

Të hyrat vetanake kanë shënuar progres të jashtëzakonshëm, duke tejkaluar planifikimin buxhetor. Deri në këtë pjesë të muajit dhjetor, janë realizuar 3,316,138.01 euro, duke tejkaluar planifikimin prej 2,532,006.00 euro. Në raport me vitin 2023, progresi është rritur me 30.93%.

Kryetari Imri Ahmeti gjatë takimit me qytetarë theksoi se Komuna e Lipjanit gjatë vitit 2024 është renditur ndër komunat me performancë të mirë, sipas vlerësimeve nga organizata dhe institucione vendore e ndërkombëtare. Ai ka përmendur lajmin e mirë që gjatë fundit të vitit 2024 për përfitimin e Grantit të Performancës prej 1,041,380.61 euro, një arritje që pasqyron menaxhimin e mirë, transparencën dhe llogaridhënien e komunës sonë.

Për transparencë buxhetore, Komuna e Lipjanit është renditur e para nga organizata GAP dhe ka marrë vlerësime të larta nga KDI dhe organizata të tjera.

Në fund të takimit, Kryetari Imri Ahmeti uroi qytetarët për festat e fundvitit dhe i ftoi të vazhdojnë bashkëpunimin për zhvillimin e qytetit dhe vendbanimeve. Ai theksoi se sukseset nuk mund të arrihen pa përfshirjen dhe aktivizimin e qytetarëve.

Qytetarët prezent në këtë takim publik, kanë shprehur falënderime për Kryetarin Ahmeti, për angazhimin në kryerjen e punëve të shumta që po bëjnë për të përmirësuar jetën e qytetarëve të Komunës së Lipjanit si dhe paraqiten kërkesat për investime kapitale në të ardhmen krahas lokaliteteve të tyre e të cilat janë më prioritet për ta.

Po ashtu qytetarët prezent kanë pasur rastin të bëjnë pyetje rreth shumë qështjeve me rëndësi të marrin përgjigje nga vet kryetari Imri Ahmeti.

Pastaj Kryetari i Komunës, Imri Ahmeti, e hapi diskutimin për të pranishmit.

Temat e Konsultimit	Komentet	Kush ka komentuar	Përgjigje në pyetjet/komentet e parashtruara	Komente (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
Raport nga tubimi i dytë publik i kryetarit në dhjetor të vitit 2024	Ka thënë se ne si shoqëri civile kemi pas bashkëpunim shumë të mirë me Komunë e Lipjanit, po ashtu edhe me kryetaret e këshillave të fshatrave, andaj me mirëkuptim kërkoj që ky bashkëpunim të vazhdoj edhe në të ardhmen.	<b>Bekim Krasniqi, nga OJQ YAHR,</b>	<b>Kryetari Imri Ahmeti:</b> Përveq që ka theksuar nevojën e bashkëpunimit me OJQ-të dhe të gjithë qytetarët e Komunës së Lipjanit ka theksuar se ky bashkëpunim do të vazhdojë domosdo edhe në të ardhmen.	<b>Komentimi pranua Plotësisht</b>
Raport nga tubimi i dytë publik i kryetarit në dhjetor të vitit 2024	Tha se do ta ngris një pyetje për një qështje që e kam ngritur disa herë për asfaltimin e rrugicave ne lagjen e Akllapit, ku ne kemi nënshkruar marrëveshje te	<b>Zymer Ahmeti përfaqësues i lagjes e Akllapit</b>	<b>Kryetari Imri Ahmeti:</b> Tha se ato rrugica në të cilat nuk ka probleme pronësore ose bëjnë deklarate me shkrim palët te noteri se nuk kërkojnë kompensim nga komuna, ne do ti asfaltojmë.	<b>Komentimi pranua Plotësisht</b>

	noteri për atë rrugë, me te cilën deklarohemi se nuk kërkojmë kompensim. A pritët të asfaltohet ajo rrugë.			
Raport nga tubimi i dytë publik i kryetarit në dhjetor të vitit 2024	Unë si kryesues i komitetit për komunitete, ju falënderoj të gjithëve për bashkëpunimin që kemi pas, po ashtu ju falënderoj për të gjitha kërkesat që i kemi ngrit qoftë si fshat qoftë si komitet e të cilat kanë hasur në mirëkuptim dhe janë realizuar nga Komuna e Lipjanit. Duke shpresuar për një bashkëpunim edhe në të ardhmen.	<b>Skender Bikliqi, Janjevë</b>	<b>Kryetari Imri Ahmeti:</b> Ka theksuar nevojën e bashkëpunimit me gjitha grupe e interesit dhe të gjithë qytetarët për një zhvillim me të qëndrueshëm të komunës, duke u shprehur që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në vazhdim.	<b>Komenti u pranua Plotësisht</b>
Raport nga tubimi i dytë publik i kryetarit në dhjetor të vitit 2024	Në emër të KBI në Lipjan ju falënderoj për bashkëpunimin e mirë që kemi pas po ashtu edhe për punët e realizuara në teren duke filluar nga shpenzimet varrimit për të gjithë qytetarët e komunës tonë, pastaj pastrimi i varrezave dhe shumë aktivitete të tjera, shpresoj që ky bashkëpunim do	<b>Zaim Baftiu, nga KBI Lipjan,</b>	<b>Kryetari Imri Ahmeti:</b> Ka theksuar nevojën e bashkëpunimit me gjitha grupet e interesit dhe të gjitha institucionet e tjera edhe këto fetare, duke u shprehur që ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në vazhdim.	<b>Komenti u pranua Plotësisht</b>



	të vazhdoj edhe tutje.			
Raport nga tubimi i dytë publik i kryetarit në dhjetor të vitit 2024	Falënderoj për bashkëpunimin dhe punimet që janë bërë në fshatin Magure, mirëpo kanë mbetur edhe disa rrugica të pa asfaltuara si dhe është dëmtuar tregu gjatë punimeve.	<b>Ramiz Gashi, përfaqësues i fshatit Magure</b>	<b>Kryetari Imri Ahmeti:</b> Ka se rrugicat të cilat janë ta pa asfaltuara aty ku nuk kemi probleme pronësore do të asfaltohen, por do e rregullojmë edhe tregun e dëmtuar.	<b>Komenti u pranua Plotësisht</b>
Raport nga tubimi i dytë publik i kryetarit në dhjetor të vitit 2024	Është shprehur i kënaqur me investimet që janë bërë në Janjevë. Por ka edhe disa punë që duhet të bëhen si ndricimi publik i cili ka mbetur në gjysmë në disa pjesë po ashtu ka probleme dhe me kanalizim dhe ujësjellës në disa vende.	<b>Behxhet Kongjeli Janjevë,</b>	<b>Kryetari Imri Ahmeti:</b> Në Janjevë shume shpejtë do të kryhet ndricimi publik po ashtu edhe renovimi i shkollës, por gjithashtu do të intervenohet edhe me kanalizimin.	<b>Komenti u pranua Plotësisht</b>
Raport nga tubimi i dytë publik i kryetarit në dhjetor të vitit 2024	Tha se edhe unë si përfaqësuese e këshillit të fshatit Shale ju falënderoj për bashkëpunimin që kemi pas. Ka pas investime në fshatin Shalë, duke u punuar për të mirën e këtyre qytetarëve, shpresoj që ky bashkëpunim do të vazhdoj edhe tutje dhe kërkesat tona si fshat të hasin në mirëkuptim dhe të	<b>Xhyle Korupzi, nga Shala,</b>	<b>Kryetari Imri Ahmeti:</b> Është obligim i yni që qytetarëve të komunës së Lipjanit të ju sigurojmë kushte më të mira për jetë dhe ne do bëjmë përpjekje që të gjitha kërkesat e juaja e sidomos ato më prioritare për banorët e Shalës do i planifikojmë dhe do i realizojmë.	<b>Komenti u pranua Plotësisht</b>

	gjejn mbshtetjen e komunës.			
Raport nga tubimi i dytë publik i kryetarit në dhjetor të vitit 2024	Tha se në fshatin Grackë ka nevojë për investime pasi që mungon trotuari, ndriçimi publik dhe asfaltimi i disa rrugicave.	<b>Ali Sopa, përfaqësues i fshatit Grackë,</b>	<b>Kryetari Imri Ahmeti:</b> Tha se sa i përket kontratës për mirëmbajtje për ndriçim publik ka qen deri tani në OSHP, por shume shpejt do te nënshkruhet dhe do te rregullohet aty ku ka pas probleme. Rrugicat te cilat janë ta pa asfaltuara aty ku nuk kemi probleme pronësore do te asfaltohen.	<b>Komenti u pranua Plotësisht:</b>
Raport nga tubimi i dytë publik i kryetarit në dhjetor të vitit 2024	Tha se në fshatin tonë është investuar në disa projekte, po ashtu është ndihmuar me mjete financiare edhe klubi i volejbollit Skënderbeu dhe ju falënderojmë për bashkëpunimin qe kemi pas, shpresoj që ky bashkëpunim do të vazhdoj edhe tutje dhe kërkesat tona si fshat të gjejnë mbshtetjen e komunës.	<b>Imri Lacaj, nga fshati Kraishtë,</b>	<b>Kryetari Imri Ahmeti:</b> Është obligim i yni që qytetarëve të komunës së Lipjanit të ju sigurojmë kushte më të mira për jetë dhe ne do bëjmë përpjekje që të gjitha kërkesat e juaja e sidomos ato më prioritare për banorët e Kraishtes do i planifikojmë dhe do i realizojmë.	<b>Komenti u pranua Plotësisht</b>
Raport nga tubimi i dytë publik i kryetarit në dhjetor të vitit 2024	Tha se në Lipjan të gjitha punët thuaj se janë përfunduar, ka mbet vetëm edhe një punë e madhe të kryhet ajo është që ti ndryshohet emri Lipjanit dhe ti bëhet emri Ulpiana.	<b>Haki Lahu, nga fshati Vrrellë e Goleshit,</b>	<b>Kryetari Imri Ahmeti:</b> Është obligim i yni që qytetarëve të komunës së Lipjanit të ju sigurojmë kushte më të mira për jetesë, por edhe propozimin e juaj do e shqyrtojmë si institucion.	<b>Komenti u pranua Plotësisht</b>

Raport nga tubimi i dytë publik i kryetarit në dhjetor të vitit 2024	Ka falenderuar përfaqësuesit komunal për investimet që janë në Brus, mirëpo kam një kërkesë që gjatë sezonës së dimrit të pastrohet dhe rruga përtej fshatit Brus.	<b>Engjell Gashi, nga fshati Brus</b>	<b>Kryetari Imri Ahmeti:</b> Ne do të angazhohemi që përmes operatorëve t'i pastojnë edhe ato rrugë dhe të gjitha rrugët që qarkullojnë qytetarët.	<b>Komenti u pranua Plotësisht</b>
Raport nga tubimi i dytë publik i kryetarit në dhjetor të vitit 2024	Ka falenderuar kryetarin për ndihmën që na ka ofruar neve si bujq, por kam një kërkesë, që të behet një kooperativë.	<b>Valbona Sopa, fermere nga fshati Sllovi</b>	<b>Kryetari Imri Ahmeti:</b> Është obligim i yni që të gjitha këkesat e qytetarëve ti shqyrojmë dhe të veprojmë në mënyrë ligjore.	<b>Komenti u pranua Plotësisht</b>

Shtojcë: lista e pjesëmarrësve

Udhëheqëse e Sektorit për Komunikim me Publikun

  
Bukurie Zejnullahu-Jashari

Lipjan, 22.01.2025



REPUBLIKA E KOSOVËS  
 REPUBLIKA KOSOVA  
 REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
 OPŠTINA LIPLJAN  
 MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lista e pjesëmarrësve në takimim e Kryetarit me Qytetarë

Vendi: Salla e kuvendit, Data: 27.12.2024, Ora 10:00

Nr. Ren.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
1	FEHMË GASTANI	JANJEK	
2	Arush Binligi	JANJEK	
3	ZAIM BAFSHI	KRAISHIT	
4	BURIM ARIFI	LIPJAN	
5	FATON MAFSHI	SHALL	
6	Habibellah	Getae Ro	
7	Xhafa Korpuz	SHALL	
8	Kamer Podrimzaku	Lipjan	
9	Milaim Xhemaj	Graçeqe e vjetër	
10	Donjeta Krasniqi	Lipjan	
11			
12	RAMIZ GASHI	MAGURE	
13	Shkender GASHI	DUBANI e MADHE	
14	BEKIM KRASHI	LIPJAN / YAHIR	
15	Art Krasniqi	Lipjan / YAHIR	
16	BASHAR IBRAHIMI	ALLOGOC	
17	Fymer Ahmeti	Lipjan	
18	Beqir Ahmeti Komxhi	JANJEK	
19	Ali Tahir	Ujgoc	
20	Ali Bogdan	Graçeqe e vjetër	
21	EMRIS GRASHI	BRUS	
22	Shorimet	Krahinë	
23	SINAN GASHI	KROJMIK	
24	Jovica Miric	LIPJAN	
25	Bedri Baj	BUDAR	
26	Shehriq Washisello	RIMAR i vogël	
27	HABIME HAZIRI	LIPJAN	
28	FITIM - GASHI	JANJEK	
29	Bakir Bajullahu	Banull	
30	Hyra Bytyci	GRAGE	
31	Leonida Asllani	Hullat i vogël	
32	Bahar Baj	BUDAR	
33	Hodir Baj	Lipjan	
34	ARMEND ALI	KRASHI	

